



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:305299

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05709853

C.nr.5300/2023

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.Sh. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.Q. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 727.49, euro, jashtë seancës së e shqyrtimit me datë 20.05.2024 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET PJESËRISHT** kërkesëpadia e paditësit F.Sh. nga Prizreni, **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit t’ia kompensoj në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 30 dhjetor - 31 Dhjetor 2020, në shumën prej 0.05 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 174.12 euro;
3. Për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022, në shumën prej 529.99 euro.

**Në shumën e përgjithshme prej 708.85 (shtatëqind e tetë euro e tetëdhjetë e pesë cent)**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 29.12.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**II. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, në shumën prej 0.79 euro, në emër të pagesës mbi bazën e inflacionit për periudhën 01 dhjetor-29 dhjetor 2020 për 28 ditë, **si e pa bazuar**.

**III. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesës së paditësit, emër të kompensimit të inflacionit në pagë në shumën prej 14.85 euro, përtej shumës së gjykuar si në dispozitivin nën I, **si e pabazuar**.

**IV. DETYROHET** e paditura, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **125.00 (njëqind e njëzetë e pesë) euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

## **A r s y e t i m**

Paditësi F.Sh. nga Prizreni, përmes të autorizuarës së tij av. A.Q. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 29.12.2023 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në të cilën ka theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënës në Gjimnazin “Remzi Ademaj” në Prizren. Duke llogaritur periudhën kohore, prej hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive, paditësi i ka takuar e drejta e kompensimit për shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, mirëpo i njëjti deri më tani nuk është kompensuar. Andaj mbi bazën e të lartcekurave e duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit të Punës, Kontratës Kolektive të Arsimit, neni 35, pika 10, i cili përcakton kompensimin nga shkalla e inflacionit, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë dhe 21.00 euro për taksën gjyqësore.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 24.04.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja

kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpafia e paditësit është e pa bazuar. Në fund ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit prej vitit 2020 është parashkruar, sepse sipas nenit 353 të LMD-së kjo e drejtë është parashkruar sepse kanë kaluar mbi 3 vite, andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpafia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Prizreni - Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën, në institucionin arsimor "Remzi Ademaj" në Prizren, si mësimdhënës, nga vërtetimi me numër të referencës 184/2023, e datës 13.02.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune si mësimdhënës i Historisë në Gjimnazin "Remzi Ademaj" në Prizren nga data 01.09.2010 deri më 10.02.2023. Bazuar në Listën e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë së paditëses e që është shuma prej 459.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeks të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se "Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të".

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se "Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të

*Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata llogaritjen e kompensimit mbi bazën e inflacionit e ka llogaritur sipas pagës 427.00 euro dhe jo sipas pagës bazë të paditëses 459.00 euro pasi që kërkesa e paditësit ka qenë e llogaritur sipas kësaj shume andaj edhe përlllogaritja është bërë në këtë mënyrë:*

- Për periudhën 30 Dhjetor – 31 Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh pagën e llogaritur në shumën prej 427.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 0.05 euro ( $427 \times 0.2\% = 0.85 \div 31 = 0.02 \times 2 \text{ ditë} = 0.05 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh pagën e llogaritur në shumën prej 427.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 174.12 euro ( $427 \times 3.4\% = 14.51 \times 12 \text{ muaj} = 174.12 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën Janar 2022 – 21 nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh pagën e llogaritur në shumën prej 427.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është euro ( $427 \times 11.6\% = 49.53 \times 10 \text{ muaj} = 495.32$ ), si dhe për 21 ditë të muajit nëntor ( $49.53 \div 30 = 1.65 \times 21 \text{ ditë} = 34.67 \text{ euro}$ ) apo në shumën e përgjithshme prej 529.99 euro.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”,* ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë*

*kërkesëpadi*”, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës (LP-së) shprehimisht theksohet që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 29.12.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.12.2020 deri më datë 29.12.2020. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 28 ditë apo në shumën prej 0.79 euro, ndërsa paditësi e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë. Andaj, gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën nën III të dispozitivit. duke refuzuar kërkesën e paditësit Fidan Shehu, në shumën prej 14.85 euro, bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 214/2023 e datës 05.10.2023, pika III, i cili ka përcaktuar se Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me datë 22.01.2021 aplikohet për periudhën 22.01.2021 e deri me datën 21.11.2022. Andaj e ke refuzuar kërkesën e paditësit nga data 22.11.2022 deri me datën 30.11.2022.

Duke marrë për bazë se gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së vendos brenda kërkesës së palëve ndërgjyqëse dhe se paditësi ka kërkuar që kompensimi në emër të inflacionit të realizohet në bazë të pagës prej 427.00 euro, mbi këtë bazë gjykata morri për bazë lartësinë e pagës prej 427.00 euro. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën I të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (29.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 21.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 125.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm -Divizioni Civil**  
**C.nr.5300/2023, me datë 20.05.2024**

**Gjyqtari**

---

**Gëzim Shehu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.